



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.33

5 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.146, datë 2.3.2011	Për ruajtjen dhe sigurimin e godinave të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Arkivit Qendror Shtetëror dhe Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar..... 1151
Vendim i KM nr.147, datë 2.3.2011	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm, 2012 – 2014 1151
Vendim i KM nr.148, datë 2.2.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Vranisht, Ziçisht, Grapsh, Stropan dhe Hoçisht, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë 1153
Vendim i KM nr.154, datë 2.3.2011	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Baldushk, të qarkut të Tiranës 1153
Vendim i KM nr.155, datë 2.3.2011	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të mjediseve të punës të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri” 1154
Vendim i KM nr.158, datë 2.3.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, e cila preket nga ndërtimi i shkollës 9 - vjeçare, lagjja 5, Kamëz 1157
Vendim i KM nr.159, datë 2.3.2011	Për miratimin e kuotës së pranimit dhe të tarifës së shkollimit, në programet e ciklit të tretë të studimeve, të doktoratës, në Institutin e Studimeve Europiane, të Universitetit të Tiranës, në vitin akademik 2010 – 2011 1158

Vendim i KM nr.161, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Marjana Daja	1159
Vendim i KM nr.162, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Zenel Kokomiri	1159
Vendim i KM nr.163, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Muhamet Përmeti	1159
Vendim i KM nr.164, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Agim Musta	1160
Vendim i KM nr.165, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Drita Haxhiraj	1160
Vendim i KM nr.166, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Petro Zheji	1161
Vendim i KM nr.167, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Robert Radoja	1161
Vendim i KM nr.168, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Shaqir Rexhvelaj	1161
Vendim i KM nr.169, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Sherif Merdani	1162
Vendim i KM nr.170, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Ruzhdi Pulaha	1162
Vendim i KM nr.171, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Amik Kasoruh	1163
Vendim i KM nr.172, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Meri Lalaj	1163
Vendim i KM nr.173, datë 2.3.2011	Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Skifter Këlliçi	1163
Vendim i KM nr.174, datë 2.3.2011	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr.762, datë 1.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e marrëveshjes së rinovuar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”, për projektin e partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit”	1164
Udhëzim i MASH nr.11, datë 28.2.2011	Për procedurat dhe dokumentacionin për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë, programeve të studimit universitar në ciklin e parë dhe ciklin e dytë, programeve të studimeve jouniversitare, të natyrës profesionale, si dhe procedurat për pezullimin dhe revokimin e licencës	1165
Vendim i KKRT nr.83, datë 25.2.2011	Mbi heqjen e licencës së televizionit privat vendor “Tele 1”	1180

Vendim i KKRT nr.86, datë 10.3.2011	Për ndryshimin e pikës 2 të dispozitivit të vendimit të KKRT-së nr.83, datë 25.2.2011.....	1182
Kërkesë e MASH nr.297/13, datë 16.3.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kopshtit dhe shkollës fillore, publike “Kaludh”, komuna Petran, Përmet.....	1185
Kërkesë e MPPT nr.1312, datë 15.3.2011	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kuçovë-Belsh-Cërrik” (loti I-5 km).....	1185

VENDIM
Nr.146, datë 2.3.2011

**PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E GODINAVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE,
GJYKATËS SË LARTË, ARKIVIT QENDROR SHTETËROR DHE QENDRËS SË FIZIKËS
BËRTHAMORE TË ZBATUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “dh” të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Brendshme ruan dhe siguron me punonjës të Policisë së Shtetit godinat e Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Arkivit Qendror Shtetëror dhe Qendrës së Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nënshkruan aktmarrëveshje të përbashkët, për përcaktimin e të drejtave dhe të detyrimeve të ndërsjella, përkatësisht, me Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave dhe Qendrën e Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

3. Ngarkohen, për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe institucionet që merren në ruajtje sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.147, datë 2.3.2011

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE BUXHETORE TË
PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, 2012 – 2014**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve buxhetore të programit buxhetor afatmesëm, 2012 – 2014, sipas lidhjes nr.1 “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TAVANET E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NË MILIONË LEKË

Lidhja nr. 1

Emërtimi i institucionit buxhetor	Viti 2012						Viti 2013						Viti 2014					
	600-601			602-606			600-601			602-606			600-601			602-606		
	Paga+Sig. Shq.	Të tjera korente	Investime/brendshme	Investime /huaja	Transferime për fondet speciale ISSH+ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig. Shq.	Të tjera korente	Investime/brendshme	Investime /huaja	Transferime për fondet speciale ISSH+ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig. Shq.	Të tjera korente	Investime/brendshme	Investime /huaja	Transferime për fondet speciale ISSH+ISKSH+KP	Totali
1 Presidencia	106	60	20			186	111	62	22		195	116	65	20			201	
2 Kuvendi	543	290	142			975	569	300	142		1,011	592	315	142			1,049	
3 Këshilli i Ministrave	188	160	20			368	197	170	20		387	205	175	25			405	
4 Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Enerjetikës	799	350	608	1,000		2,757	837	390	620	1,000	2,837	871	400	650	1,000		2,921	
5 Ministria e Bujqësisë, Ushqim dhe Mbrojtjes Konsum.	1,787	2,564	2,389	900		7,640	1,872	3,113	2,889	1,500	9,374	1,949	3,400	3,589	2,005		10,943	
6 Ministria e Punëve Publike, Transporti dhe Telekomunik.	1,182	3,582	13,345	28,522		46,631	1,238	3,888	10,251	38,901	54,278	1,289	4,400	17,974	37,333		60,996	
10 Ministria e Financave	3,432	1,200	800		1,800	7,232	3,595	1,250	700	1,850	7,395	3,743	1,300	750		1,900	7,693	
11 Ministria e Arsimit dhe Shkencës	28,544	8,473	3,000	2,000		42,017	29,895	9,398	3,250	2,000	44,543	31,226	9,800	3,990	4,400		49,416	
12 Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	942	670	600			2,212	986	680	600		2,266	1,027	700	600			2,327	
13 Ministria e Shëndetësisë	2,487	1,839	2,784	1,000	20,919	29,029	2,875	2,090	3,000	1,500	22,053	31,318	2,746	3,333	3,500	1,500	22,884	33,983
14 Ministria e Drejtësisë	4,221	1,061	500	300	800	6,882	4,421	1,114	550	405	2,000	8,490	4,603	1,200	1,300	300	2,600	10,003
15 Ministria e Punëve të Jashtme	274	1,920	120			2,314	287	1,950	130		2,367	299	2,000	140			2,439	
16 Ministria e Brendshme	12,020	3,500	1,000	800		17,020	12,589	3,650	1,100	400	17,739	13,107	3,760	1,300	400		18,567	
17 Ministria e Mbrojtjes	7,700	5,652	3,918	1,000	4,500	22,770	8,064	5,400	5,584	1,000	24,598	8,397	5,914	6,500	1,000	4,600	26,411	
18 Shërbimi Informativ Shtetëror	1,019	295	120			1,434	1,067	300	120		1,487	1,111	305	125			1,541	
19 Drejtoria e Radiotelevizionit	0	386	90			476	0	406	100		506	0	410	100			510	
20 Drejtoria e Përgjithshme e arkivave	131	39	10			180	137	41	19		197	143	41	19			203	
22 Akademia e Shkencave	35	51	1			87	36	51	2		89	38	51	2			91	
24 Kontrolli i Lartë i Shtetit	230	51	10			291	241	53	10		304	251	53	10			314	
25 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1,130	22,590	205		32,804	56,729	1,183	24,350	180		61,458	1,232	25,800	180		38,076	65,288	
26 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	914	261	400	420		1,994	957	274	450	520	2,201	996	285	500	820		2,601	
28 Prokuroria e Përgjithshme	981	295	100			1,376	1,027	302	160		1,489	1,069	315	160			1,544	
29 Zyra e Administrimit të Buxhetit gjyqësor	1,370	310	180			1,860	1,435	330	220		1,985	1,494	345	240			2,079	
30 Gjykata Kushtetuese	79	26	3			108	82	26	2		110	86	26	2			114	
31 Agjencia Telegrafike Shqiptare	77	17	3			97	81	18	2		101	84	18	2			104	
40 Partitë politike	0	215	0			215	0	220	0		220	0	220	0			220	
50 Instituti i Statistikës	205	194	10			409	214	204	10		428	223	210	10			443	
55 Shkolla e Magjistraturës	25	29	2			56	26	30	2		58	27	30	2			59	
56 Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,000	5,200		6,200	0	0	900	4,700	5,600	0	0	800	4,500		5,300	
57 Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9	112	2			124	10	118	2		130	10	118	2			130	
63 Këshilli i Lartë i Drejtësisë	57	22	4			83	60	23	4		87	62	23	4			89	
66 Avokati i Popullit	71	16	2			89	75	16	2		93	78	16	2			96	
67 Komisioni i Shërbimit Civil	36	11	2			49	37	11	2		50	39	11	2			52	
73 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	78	23	3			104	82	623	3		708	85	25	3			113	
76 Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive	65	22	4			91	68	23	4		95	71	23	4			98	
77 Autoriteti i Konkurrencës	50	10	5			65	53	10	5		68	55	10	5			70	
78 Ministria e Integritimit	86	60	16			162	90	62	15		167	94	65	16			175	
82 Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	7	7	1			15	8	7	2		17	8	7	2			17	
86 Avokati i Prokurimeve	21	5	2			28	22	5	2		29	23	5	2			30	
87 Institucione të tjera qeveritare	162	500	157	400		1,219	170	289	160	400	1,019	177	260	165	400		1,002	
88 Mbrojtëse për shoqërimin civil	13	80	2			95	13	85	2		100	14	87	2			103	
89 Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	34	11	3			47	35	11	2		48	37	11	2			50	
91 Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi	21	6	3			30	22	6	2		30	23	6	2			31	
92 Instituti i Studimit të Krimeve të Komunizmit	21	2	1			24	22	2	1		25	23	2	1			26	

VENDIM
Nr.148, datë 2.2.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE “VRANISHT, ZIÇISHT, GRAPSH, STROPAN DHE HOÇISHT, DHE
MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 5 e të shkronjës “b” të pikës 3 të nenit 23 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (Ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve “Vranisht, Ziçisht, Grapsh, Stropan dhe Hoçisht” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Geo Consult”, sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentraleve “Vranisht, Ziçisht, Grapsh, Stropan dhe Hoçisht” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.154, datë 2.3.2011

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS
BALDUSHK, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Baldushk të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 141 (njëqind e dyzet e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1 051 (një mijë e pesëdhjetë e një).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Baldushk për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Baldushk

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
811	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi
814-829	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
830-837	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
838	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
840,841,842,844,845,846,848,849,850,851,852,853,854,856,857,858,859,860,861,862,963,864,866,867,868,870-881	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
843,847,855,865,869	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
912,913-1009	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
1010-1051	Varreza publike.	Në pronësi

VENDIM
Nr.155, datë 2.3.2011

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTERIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË RRUGËVE, TË MJEDISEVE TË PUNËS TË INSTITUTIT TË MONUMENTEVE TË KULTURËS “GANI STRAZIMIRI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15/c dhe 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të mjediseve të punës të Institutit të Monumenteve të Kulturës “Gani Strazimiri”, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi vetëm të mjediseve ku ushtrohet veprimtaria administrative e këtij institucioni.

3. Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Drejtoria e Përgjithshme të Rrugëve) i ndalohej ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror: Rrethi Tiranë
Bashkia/komuna: Tiranë
Fusha e përdorimit të pronës: Zyra administrative

Nr.rend	A			B			Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/emri përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të veçanta)
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës adresë	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale sa ndërtesa (m ²)				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Zyra Kati II	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Tiranë Rr.Sami Frashëri, nr.3, Tiranë	306 m ²	Kati II 306 m ²	Administratë	Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit	Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Tiranë	Ndërtesa është 5-katëshe Kati I+ bodrumi: Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit Kati III,IV, V- DPRR (Në katin I ndodhet gjeneratori i DPRR-së

PLANIMETRIA KATI I DYTE I NDERTESES (DPRr)



VENDIM
Nr.158, datë 2.3.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS
9-VJEÇARE, LAGJJA 5, KAMËZ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i shkollës 9 - vjeçare, lagjja 5, Kamëz.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Kamëz.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen e përgjithshme 1500 (një mijë e pesëqind) m² tokë/truall, e vlerësuar me 2 650 (dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme 3 975 000 (tre milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga bashkia Kamëz.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 3 975 000 (tre milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit maj 2011.
 7. Bashkia Kamëz të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Bashkia Kamëz, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkia Kamëz dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SHKOLLËS
9-VJEÇARE, LAGJJA 5, KAMËZ

Pronari	Zona kadastrale	Nr.i pasurisë	Sip.arë m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Kujtim Shaqir Klosi	2066	135/46	1500	2650	3975000	3975000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 3 975 000 (tre milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Shënim. Bazuar në vendimin nr.1620, datë 26.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna”.

VENDIM
Nr.159, datë 2.3.2011

PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, NË PROGRAMET E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS, NË INSTITUTIN E STUDIMEVE EUROPIANE, TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2010 - 2011

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuotës së pranimit në programet e ciklit të tretë të studimeve, të doktoratës, në Institutin e Studimeve Europiane, të Universitetit të Tiranës, për vitin akademik 2010 - 2011, gjithsej 50, të ndarë sipas programeve të studimit, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----------|
| a) Doktoratë në “Legjislacion dhe institucionet e BE-së” | 15 kuota; |
| b) Doktoratë në “Politika dhe qeverisja në Europë” | 15 kuota; |
| c) Doktoratë në “Diplomacia dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të BE-së” | 20 kuota. |

2. Në kuotën e çdo programi studimi të doktoratës caktohen dy kuota për kandidatët nga trojet jashtë kufijve.

3. Tarifa e shkollimit, për çdo program të studimeve të doktoratës në Institutin e Studimeve Europiane të Universitetit të Tiranës është 204 600 (dyqind e katër mijë e gjashtëqind) lekë, e cila paguhet në këste, të përcaktuara nga Universiteti i Tiranës.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Universitetit të Tiranës, pa efekte buxhetore shtesë.

5. Rishpërndarja e kuotave të paplotësuara bëhet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.161, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. MARJANA DAJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj.Marjana Daja, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.162, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. ZENEL KOKOMIRI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Zenel Kokomiri, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.163, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. MUHAMET PËRMETI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Muhamet Përmeti, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.164, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. AGIM MUSTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Agim Musta, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.165, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. DRITA HAXHIRAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj. Drita Haxhiraj, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.166, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. PETRO ZHEJI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Petro Zheji, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.167, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. ROBERT RADOJA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Robert Radoja, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.168, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. SHAQIR REXHVELAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtese pensioni të posaçëm shtetëror z.Shaqir Rexhvelaj, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.169, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. SHERIF MERDANI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Sherif Merdani, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.170, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. RUZHDI PULAHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Ruzhdi Pulaha, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.171, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z. AMIK KASORUHO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z. Amik Kasoruh, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.172, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR ZNJ. MERI LALAJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror znj.Meri Lalaj, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.173, datë 2.3.2011

PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR Z.SKIFTER KËLLIÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Dhënien shtesë pensioni të posaçëm shtetëror z.Skifter Këllici, në masën e pensionit maksimal, por shuma e pensionit që i takon sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, plus këtë shtesë, të mos kalojë dyfishin e pensionit maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.174, datë 2.3.2011

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.762, DATË 1.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË RINOVUAR, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “MICROSOFT
CORPORATION”, PËR PROJEKTIN E PARTNERITETIT STRATEGJIK NË FUSHËN
E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, 23 e 27 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 2 të vendimit nr.762, datë 1.9.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... e institucioneve qendrore ...” shtohen fjalët “... dhe për marrëveshjen e Forcave të Armatosura ...”.

b) Shkronja “ç” shfuqizohet.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministri i Financave, Ministri i Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.11, datë 28.2.2011

PËR PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONIN PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË, PROGRAMEVE TË STUDIMIT UNIVERSITAR NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË, PROGRAMEVE TË STUDIMEVE JOUNIVERSITARE, TË NATYRËS PROFESIONALE, SI DHE PROCEDURAT PËR PEZULLIMIN DHE REVOKIMIN E LICENCËS

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 43, nenit 44 dhe 44/1, nenit 64, nenit 99/3 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURAT PËR LICENCIMIN E NJË INSTITUCIONI TË RI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË DHE FILIALIT TË NJË INSTITUCIONI

1. Subjekti juridik, vendas ose i huaj, për marrjen e licencës për hapjen e një institucioni të arsimit të lartë privat dhe filialit të një institucioni, paraqet kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) brenda datës 15 mars të çdo viti, së bashku me projektin konkret, i cili duhet të përmbajë:

a) tipin e institucionit të arsimit të lartë, emrin dhe objektivat afatgjatë të veprimtarisë arsimore, kërkimore dhe zhvilluese të institucionit;

b) të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që zotëron subjekti juridik, burimet materiale, bibliotekare dhe informatike. Këto të dhëna të shoqërohen nga deklarata analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklarata e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, sipas formularëve të përcaktuar në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 të Ministrisë së Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;

c) organizimin e studimeve, planet mësimore për programet e studimit, programet e lëndëve/moduleve, të shoqëruara me syllabuset përkatëse me firmën e titullarit të lëndës që harton programin përkatës, shoqëruar me një CV të këtij të fundit, nivelet dhe emërtimet e diplomave në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. I gjithë dokumentacioni i kësaj pike të jetë në dy kopje (njëra nga të cilat të jetë në CD-ROOM);

d) një institucion privat, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër është i detyruar të paraqesë një dokument zyrtar mbi këtë akreditim;

e) një dokument zyrtar bashkëpunimi, si dhe dokument zyrtar të akreditimit të institucionit bashkëpunues, nëse ka, në rast se institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj;

f) strukturën e institucionit (organigrama), e sigluar nga administratori i institucionit;

g) statutin, në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i cili duhet të jetë dokument origjinal ose kopje e noterizuar;

h) modelin e kontratës së regjistrimit që studenti lidh me IAL-në, sipas termave të parashikuar në shtojcën IV të këtij udhëzimi;

i) deklaratë për të dhënat për personelin akademik që do të punësohet dhe kriteret e punësimit për çdo vend pune në institucionin e arsimit të lartë, e cila duhet të jetë sigluar nga administratori i shoqërisë;

j) deklaratë për plotësimin e standardeve akademike sipas përcaktimeve përkatëse në shtojcën nr.2, bashkëlidhur udhëzimit dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi, e sigluar nga administratori i shoqërisë;

k) relacion për ambientet mësimore duke pasur parasysh standardet e përcaktuara në shtojcën nr.3 bashkëlidhur udhëzimit;

l) ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve (QKR) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat;

m) deklaratën e subjektit, administratorit dhe ortakut(-ëve) që nuk janë në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, proces gjyqësor, proces hetimi, sipas formularit të autodeklarimit bashkëlidhur këtij udhëzimi;

n) jetëshkrimet e hollësishme të administratorit dhe ortakut(-ëve) të shoqërisë, të shoqëruara me dëftesat dhe diplomat e shkollimit.

2. Në rast deklarimi të rremë, subjekti aplikues i nënshtrohet masave të parashikuara në Kodin Penal. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar në formularin e autodeklarimit dhe të pikave të këtij udhëzimi, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat nis procedurën e kontrollit të tyre, duke ia përcjellë këto të dhëna organit kompetent.

B. Procedura e licencimit

1. Kërkesa dhe projekti depozitohen në Drejtorinë e Zhvillimit të Arsimit Privat, e cila në bashkëpunim me sektorin e shërbimeve juridike kryejnë, brenda katër javëve, vlerësimin teknik dhe juridik të aplikimit për të parë nëse ai është plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të kreut I.

Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, kur projekti rezulton me mangësi, i kërkon subjektit, që, brenda një muaji, t'i plotësojë ato. Për efekt të llogaritjes së afateve, data e plotësimit të projektit do të konsiderohet si datë e paraqitjes së kërkesës. Kur projekti nuk plotësohet brenda këtij afati, kërkesa refuzohet dhe projekti arkivohet në protokollin e MASH-it.

2. Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dërgon, brenda tri javëve, kur projekti është i plotë, një kopje të dokumentacionit të pikës 1, “c”, “d”, “e” (nëse ka), “f”, të kreut I të udhëzimit tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). APAAL, në mbështetje të pikës 4 të nenit 44 dhe neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kryen vlerësimin në përmbajtje brenda 45 ditëve nga marrja e aplikimit dhe më pas ia përcjell atë Këshillit të Akreditimit. Për kryerjen e këtij procesi, Këshilli i Akreditimit angazhon edhe ekspertë të jashtëm, të vendit ose të huaj, sipas programeve të studimit që do të vlerësohen.

3. Këshilli i Akreditimit (KA), brenda 90 ditëve, shprehet me shkrim për programin/et e studimit të paraqitur. Vlerësimi i KA-së, i përcjellë në Drejtorinë e Zhvillimit të Arsimit Privat, është vlerësim pozitiv ose negativ. Vlerësimi negativ duhet të jetë i argumentuar.

4. Vlerësimi pozitiv apo negativ me shkrim i KA-së bashkëlidhet me projektin, i cili i kthehet Drejtorisë së Zhvillimit të Arsimit Privat, për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

5. Në rastin e një vendimi negativ të KA-së, Ministri refuzon projektin. Refuzimi i përcillet kërkuarit, i cili ka të drejtë të parashtrijë objeksionet e veta. Në këtë rast, një kopje e vendimit me shkrim i jepet kërkuarit, i cili ka të drejtë të parashtrijë objeksionet e veta. Kërkesa dhe objeksionet e kërkuarit shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 15 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me projektin arkivohet në protokollin e Ministrisë.

6. Në rastin e një vendimi pozitiv nga KA-ja, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat e përcjell projektin te ministri për vendim. Në rast se janë plotësuar të gjitha kërkesat sipas këtij udhëzimi, Ministri i propozon Këshillit të Ministrave licencimin e institucionit të arsimit të lartë privat (IAL). Kërkesa e miratuar së bashku me projektin arkivohet në protokollin e ministrisë.

7. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të kërkojë nga APAAL dhe KA një raport të hollësishëm mbi vendimin.

8. Subjekti juridik, i licencuar për herë të parë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, duhet të aplikojë për marrjen e lejes së fillimit të veprimtarisë akademike dhe të dorëzojë këto dokumente:

a) Relacionin e verifikimit të godinës, të përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari në ndërtim” (shoqëruar me kopjen e noterizuar të licencës së këtij të fundit);

b) Lejen higjieno-sanitare;

c) Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë së qiradhënësit dhe në rastet e godinave që janë në proces legalizimi vërtetim nga ALUIZNI;

d) Listën e plotë emërore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe personelit të ftuar, si dhe të autoriteteve drejtuese, për të gjitha programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën punësimit dhe titullin, dhe gradën përkatëse. Kjo listë duhet të jetë e sigluar nga administratori. Dosja e personelit duhet të përmbajë:

i) jetëshkrimin;

ii) kontratën e punës;

iii) dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet (të noterizuara);

iv) letrën e angazhimit të çdo anëtari të personelit akademik dhe lejen e punëdhënësit kryesor, të parashikuar në nenin 50, pika 1.1, të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (sipas shtojcës nr.5 bashkëlidhur këtij udhëzimi);

e) Numrin e përgjithshëm, si edhe atë të pritisëm të studentëve, referuar standardeve akademike dhe të infrastrukturës, të deklaruara nga subjekti (të sigluar nga titullari dhe me vulën e institucionit);

f) Tarifën e shkollimit për studentët;

g) Raportin financiar të themelimit të institucionit (shumën e investimit, kostot e investimit fillestar, kostot operacionale, koston e parashikuar për student etj.);

h) Një dokument bankar, ku të vërtetohet se është depozituar për ruajtje një shumë, e cila është e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të IAL-së për një vit (në bazë të formulës së përcaktuar nga vetë IAL-ja për koston e një studenti).

9. Subjekti juridik mund të fillojë veprimtarinë mësimore vetëm pas lëshimit të urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës për fillimin e veprimtarisë akademike, në përmbushje të angazhimeve të deklaruara.

10. Dhënia e lejes për fillimin e veprimtarisë akademike bëhet efektive për vitin akademik që fillon pas datës së vendimit të Këshillit të Ministrave.

11. Licenca nuk mund t’i transferohet në mënyrë të drejtpërdrejtë një subjekti tjetër juridik. Kur një subjekt juridik në zotërim të licencës, kërkon t’ia transferojë këtë licencë një subjekti tjetër, ky i fundit duhet të ndjekë procedurën e plotë të licencimit sipas kreut I të këtij udhëzimi. Transferimi i licencës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Të gjitha dispozitat e këtij udhëzimi, për të drejtat dhe detyrat e titullarit të licencës, zbatohen edhe për titullarin e ri të licencës.

KREU II

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË REJA TË STUDIMIT DHE FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE

1. Hapja e programeve të studimit bëhet kur plotësohen kriteret infrastruktorë, organizativë, si dhe kriteret lidhur me personelin akademik që do të aktivizohet në realizimin e disiplinave apo veprimtarive të tjera formuese, duke pasur parasysh dhe objektivat e nevojat për zgjerimin e sistemit të arsimit të lartë.

2. Njësia bazë i propozon njësisë kryesore hapjen e programeve të studimit në formën e një projekti, i cili diskutohet në senatin akademik. Vendimi i senatit akademik për miratimin e projektit i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës deri më 28 shkurt të çdo viti kalendarik. Propozimet për hapjen e programeve të studimit bëhen pasi të jenë plotësuar kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007, të ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3. Projekti, me kërkesën e hapjes së programeve të reja të studimeve, duhet të shoqërohet me këto dokumente:

a) fotokopje të licencës dhe të lejes për fillimin e vitit akademik;

b) për subjektet që kanë filluar veprimtarinë e tyre sipas ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, fotokopje të lejes së dhënë për hapjen e institucionit;

c) planin financiar të projektit që përmban përllogaritjet financiare, të dhëna për burimet financiare, shoqëruar me dokument bankar që shpreh vlerën e burimeve financiare që subjekti juridik zotëron, burimet

materiale dhe informatike, të nevojshme për programet e reja të studimit. Këto të dhëna të shoqërohen nga deklaratat analitike për tatimin mbi të ardhurat dhe deklaratat e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera, sipas formularëve të përcaktuar në udhëzimin nr.5, datë 30.1.2006 të Ministrisë së Financave “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

- i) Deklarata analitike për tatimin mbi të ardhurat;
- ii) Deklarata e tatimit mbi të ardhurat nga burime të tjera;
- iii) Deklarata vjetore e tatimit mbi fitimin;
- iv) Deklarata e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

d) planet mësimore për programet e studimit, programet e lëndëve/moduleve të shoqëruara me syllabuset përkatëse me firmën e titullarit të lëndës që harton programin përkatës, shoqëruar me një CV të këtij të fundit, nivelet dhe emërtimet e diplomave në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. I gjithë dokumentacioni i kësaj pike të jetë në dy kopje (njëra nga të cilat të jetë në CD);

e) dokument zyrtar bashkëpunimi në rastet kur institucioni parashikon të ofrojë programe studimi të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj, si dhe dokument zyrtar të akreditimit të tyre në vendin e origjinës, nëse ka;

f) listën e plotë emërore të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, si dhe personelit të ftuar, si dhe të autoriteteve drejtuese, për të gjitha programet e studimit, së bashku me ngarkesat dhe formën e punësimit, si dhe titullin dhe gradën përkatëse. Dosja e personelit duhet të përmbajë:

- i) jetëshkrimin;
- ii) kontratën e punës;
- iii) dokumente që vërtetojnë shkollimin e kualifikimet (të noterizuara);
- iv) letrën e angazhimit të çdo anëtarit të personelit akademik dhe lejen e punëdhënësit kryesor (sipas shtojcës nr.5 bashkëlidhur këtij udhëzimi);

g) modelin e kontratës së regjistrimit që studenti lidh me IAL-në, sipas termave të parashikuara në kreun IV të këtij udhëzimi;

h) deklaratën për plotësimin e standardeve akademike sipas përcaktimeve përkatëse në shtojcën nr.2 bashkëlidhur udhëzimit dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi (deklarata e nënshkruar nga titullari dhe me vulë të institucionit);

i) relacionin e verifikimit të godinës, të përpiluar nga një person juridik apo fizik i licencuar pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari në ndërtim” (shoqëruar me kopjen e noterizuar të licencës së këtij të fundit);

j) planimetrinë dhe planvendosjen e godinës së institucionit, së bashku me bazën materiale dhe didaktike. Aktin e posedimit të godinës apo kontratën e qirasë me afat së paku 3-vjeçar, të shoqëruar me vërtetimin e pronësisë të qiradhënësit dhe në rastet e godinave që janë në proces legalizimi vërtetim nga ALUIZNI që janë në proces legalizimi;

k) numrin e përgjithshëm dhe atë të priturshëm të studentëve, referuar standardeve akademike dhe të infrastrukturës, të deklaruara nga subjekti (të sigluar nga titullari dhe me vulën e institucionit);

l) tarifën e shkollimit për studentët;

m) lejen higjieno-sanitare (dokument i vitit të fundit, kopje e noterizuar);

n) vërtetimin nga njësi e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit (kopje e noterizuar).

4. Projekti depozitohet në Drejtorinë për Zhvillimin e Arsimit Privat, e cila në bashkëpunim me sektorin e shërbimeve juridike bëjnë vlerësimin teknik dhe juridik të aplikimit brenda dy javëve, nëse është plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 4 të kreut I. Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat, kur projekti rezulton me mangësi, i kërkon subjektin, që, brenda një muaji, t’i plotësojë ato. Për efekt të llogaritjes së afateve, data e plotësimit të projektit do të konsiderohet si datë e paraqitjes së kërkesës. Kur projekti nuk plotësohet brenda këtij afati, kërkesa nuk pranohet.

5. Në rast deklarimi të rremë, subjekti aplikues u nënshtrohet masave të parashikuara në Kodin e Penal. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar në formularin e autodeklarimit dhe të pikave të këtij udhëzimi, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat inicion procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna organit kompetent.

6. Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Privat dërgon, brenda tri javëve, kur projekti është i plotë, një kopje të dokumentacionit të pikës 3, “d”, “e” (nëse ka) të këtij kreu, tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL). APAAL, në mbështetje të pikës 4, të nenit 44 dhe neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kryen vlerësimin në përmbajtje brenda 45 ditëve nga marrja e aplikimit dhe më pas ia përcjell atë Këshillit të Akreditimit. Për kryerjen e këtij procesi Këshilli i Akreditimit angazhon edhe ekspertë të jashtëm, të vendit ose të huaj, sipas programeve të studimit që do të vlerësohen.

7. Këshilli i Akreditimit (KA), brenda 90 ditëve, shprehet me shkrim, për programin/et e studimit të paraqitur. Vlerësimi i KA-së i përcjellë në Drejtorinë e Zhvillimit të Arsimit Privat është vlerësim pozitiv ose negativ. Vlerësimi negativ duhet të jetë i argumentuar.

8. Vlerësimi pozitiv apo negativ me shkrim i KA-së bashkëlidhet me projektin, i cili i kthehet Drejtorisë së Zhvillimit të Arsimit Privat për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

9. Në rastin e një vendimi negativ të KA-së, Ministri refuzon projektin. Refuzimi i përcillet kërkuesit, i cili ka të drejtë të parashtojë objeksionet e veta. Në këtë rast një kopje e vendimit me shkrim i jepet kërkuesit, i cili ka të drejtë të parashtojë objeksionet e veta. Kërkesa dhe objeksionet e kërkuesit shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili brenda 15 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me projektin arkivohen në protokollin e Ministrisë.

10. Në rastin e një vendimi pozitiv nga KA-ja, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat e përcjell projektin te ministri për vendim. Projekti arkivohet në protokollin e ministrisë.

11. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë të kërkojë nga APAAL dhe KA një raport të hollësishëm mbi vendimin.

KREU III

PROCEDURAT PËR MIRATIMIN E RIORGANIZIMIT TË PROGRAMIT/VE TË STUDIMIT SIPAS KËRKESËS SË BËRË NGA INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

1. Kërkesa, së bashku me programin/et e riorganizuar, sjellë nga institucioni privat i arsimit të lartë, depozitohet/n në Drejtorinë për Zhvillimin e Arsimit Privat, e cila brenda dy javëve e dërgon tek Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL), e cila e shqyrton dhe në mbështetje të pikës 4, të nenit 44 dhe neneve në vijim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, jep vlerësimin e vet për programin/et e studimit të ndryshuar, brenda 45 ditëve dhe ia përcjell Këshillit të Akreditimit. Për kryerjen e këtij procesi, KA angazhon edhe ekspertë të jashtëm sipas programeve të studimit që do të vlerësohen.

2. KA, brenda 90 ditëve, shprehet me shkrim për programin/et e studimit të riorganizuar.

3. Vlerësimi pozitiv ose negativ me shkrim i KA-së bashkëlidhet me programin/et e riorganizuar dhe i kthehen Drejtorisë së Zhvillimit të Arsimit Privat për vijimin e procedurave të mëtejshme sipas këtij udhëzimi.

4. Kur vlerësimi për programin e ndryshuar është pozitiv, projekti përcillet te ministri, i cili vendos për miratimin ose jo të tij. Në rast miratimi, ministri lëshon një urdhër për riorganizimin e programit.

5. Kur vlerësimi për programin e studimit/ve të riorganizuar është negativ, një kopje e vendimit me shkrim i jepet kërkuesit, i cili ka të drejtë të parashtojë objeksionet e veta. Kërkesa, së bashku me programin/et e riorganizuar dhe objeksionet e kërkuesit, shqyrtohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, i cili, brenda 15 ditëve, vendos kthimin për rishqyrtim ose refuzimin përfundimtar të kërkesës. Kërkesa e refuzuar, së bashku me programin/et e riorganizuar arkivohen në protokollin e ministrisë. Arkivimi i dokumentacionit në protokollin e ministrisë ndodh edhe në rastin e miratimit të programit/ve.

KREU IV

DETYRIMET QË RRJEDHIN NGA LICENCIMI I INSTITUCIONIT PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË

A. Përgjegjshmëria

1. Institucionet private të arsimit të lartë ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore, në zbatim të tij. Ato funksionojnë me të njëjtat rregulla, të përcaktuara për institucionet homologe, publike, të arsimit të lartë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në ligj dhe aktet nënligjore.

2. Subjekti juridik është përgjegjës për gjithë veprimtarinë, administrimin dhe financimin e institucionit, të licencuar. Ai duhet të informojë Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për:

a) çdo ndryshim adrese të vendndodhjes së qendrës së IAL-së. Për ndryshimin e vendndodhjes së mjediseve mësimore, paraqet kërkesë për miratim së bashku me dokumentacionin e parashikuar në kreun II, pika 3, “i”, “j”, “k”, “m” dhe “n” të këtij udhëzimi;

b) çdo ndryshim të objektivave kryesorë të programit/eve të studimit që ofron;

c) të paraqesë çdo fillim viti tarifat për pranimet në secilin program studimi, si dhe gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë;

d) çdo fillim viti akademik brenda datës 30 tetor, paraqet:

i) listën e plotë të personelit akademik, ku të jenë të specifikuar titujt akademikë apo grada shkencore për secilin, lëndët, të cilat ata mbulojnë, si dhe forma e punësimit të tyre në institucion;

ii) listën e plotë emërore të studentëve të regjistruar sipas programeve të studimit.

B. Raportimi

1. Institucioni duhet të paraqesë një raport vjetor të nënshkruar nga rektori/titullari i institucionit pranë DZHAP-së në MASH deri më 30 korrik të çdo viti apo të një date tjetër të përcaktuar nga MASH-i. Raporti duhet të përmbajë këto të dhëna për çdo program studimi të ofruar gjatë vitit akademik:

a) Numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar sipas niveleve dhe programeve të studimit;

b) Numrin e të diplomuarve sipas niveleve dhe programit të studimit;

c) Nivelet dhe programet e studimit që ofron institucioni;

d) Dokumentin mbi performancën e shkollës (*shih pika 2 më poshtë në këtë kapitull*);

e) Katalogun e shkollës që përmban informacione mbi shkollën, statusin ligjor, akreditimin, partneritetet etj.;

f) Pagesat totale (tarifat e studimit, regjistrimit etj.) për secilin program studimi në bazë të kohëzgjatjes së studimit;

g) Informacione shtesë, të cilat MASH-i sheh të arsyeshme;

h) Në fillim të vitit, MASH-i njofton institucionet mbi formatin e raportit dhe mënyrën e dërgimit të raportit pranë MASH-it.

2. Hartimi i një dokumenti mbi performancën e shkollës, e cila duhet të përmbajë për çdo program studimi:

a) Përqindjen e studentëve kalues në vit dhe përqindjen e atyre që përfundojnë shkollën;

b) Përqindjen e të punësuarve që kanë përfunduar këtë program studimi, nëse institucioni reklamon se ky program përgatit për një karrierë apo pozicion të caktuar;

c) Përqindjen e suksesit në provimet e shtetit kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, si edhe përqindjen e profesionistëve që kanë përfunduar këtë program studimi dhe janë licencuar. Ky informacion duhet paraqitur, së bashku me burimin e informacionin dhe adresën se ku mund të konfirmohet ai;

d) Nëse programi është tepër i ri për të siguruar të dhëna mbi punësimin dhe licencimin e të diplomuarve të tij, atëherë institucioni duhet ta cilësojë atë si të tillë, duke deklaruar se: “Ky është një program i ri dhe për këtë arsye institucioni nuk disponon një informacion të mjaftueshëm mbi numrin e të diplomuarve të punësuar apo që kanë kaluar provimin e shtetit.”.

C. Regjistrimi

1. Regjistrimi i studentëve bëhet në bazë kritereve të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar:

a) Një institucion i arsimit të lartë duhet të mbajë regjistër bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore.

b) Regjistri i studentëve plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahet në ruajtje të përhershme.

c) Çdo studenti, në regjistrimin fillestar, në një institucion të arsimit të lartë, i jepet një numër unik matrikullimi, që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose certifikatës. Numri i matrikullimit përcaktohet në përputhje me udhëzimin nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

D. Të tjera

1. Licenca, që i është dhënë një subjekti juridik, bëhet e pavlefshme në rastet kur institucioni privat nuk fillon veprimtarinë mësimore-shkencore, as në vitin akademik pasardhës.

2. Ndalohet transferimi i studentëve të regjistruar në institucione private të arsimit të lartë në programe studimi në institucione publike të arsimit të lartë, ku pranimi bëhet me konkurs.

3. Një institucion privat mund të ndërpresë veprimtarinë e tij vetëm në fund të vitit akademik.

4. Një institucion privat i arsimit të lartë i licencuar, që ka organizim të programeve të studimit të ndryshëm nga ai i shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, është i detyruar ta njoftojë këtë publikisht, para fillimit të procesit të regjistrimit të studentëve.

KREU V INSPEKTIMET DHE MASAT

A. Inspektimi

1. Institucioni i nënshtrohet inspektimeve periodike nga MASH-i, APAAL-i dhe KA-ja të paktën një herë në vit.

2. Nëse gjatë inspektimeve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit të arsimit të lartë apo të këtij udhëzimi, grupi i inspektimit i ngritur me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës përgatit një raport për ministrin mbi shkeljet e evidentuara. Raporti i grupit të inspektimit i dërgohet edhe IAL-së përkatëse.

3. Pas njoftimit mbi shkeljet dhe detyrimet mbi zbatimin e normave të përcaktuara në udhëzim, institucioni dërgon një deklaratë të firmosur (deklaratë angazhimi), në të cilën angazhohet se do të plotësojë kriteret e vendosura në ligjin e arsimit të lartë dhe në këtë udhëzim.

4. Në rast se institucioni kundërshton zbatimin e angazhimeve të ndërmarra, subjekti paraqet ankesë pranë MASH-it.

5. Në rast se institucioni nuk arrin të zbatojë angazhimet brenda afatit të përcaktuar, MASH-i ndërmerr masat e duhura administrative.

B. Pezullimi, heqja e licencës

1. Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave për heqjen e licencës janë:

a) Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca hiqet kur IAL-ja nuk i përmbush më kriteret e dhënies së licencës apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

b) Konstatimi i mosplotësimit të kritereve apo shkeljes së detyrimeve bëhet, si rregull, nga organet kompetente të inspektimit.

c) Përpara marrjes së vendimit të heqjes së licencës, organi kompetent, si rregull, urdhëron ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të titullit dhe/ose pezullimin e titullit, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrat për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

d) Urdhri i pezullimit revokohet nga organi kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se titullari i licencës ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

2. Nëse gjatë inspektimit evidentohen shkeljet e mëposhtme, MASH-i ka të drejtë të propozojë pezullimin e veprimtarisë së një institucioni ose heqjen e licencës së tij.

a) Marrja e licencës së ushtrimit të veprimtarisë nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit të dokumenteve, pasqyrimin të të dhënave të pavërteta dhe çdo shkeljeje tjetër të procedurës administrative të përcaktuar në këtë udhëzim.

b) Shkelje, si: mashtrime në hartimin/lidhjen e kontratave, pretendime jo të vërteta ose çorientuese në reklama, të cilat ndikojnë mbi zgjedhjen e studentit/es dhe që rezultojnë në dëm të konsiderueshëm të tij/saj.

c) Refuzimin e institucionit për të dërguar informacionet e kërkuara nga ky udhëzim dhe nga ligji nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”.

3. Sipas ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rast të shkeljeve të përsëritura të këtij ligji dhe këtij udhëzimi, MASH-i kërkon pezullimin e licencës deri në 2 vjet. Për çdo rast, pezullimi i licencës do të kryhet vetëm në fund të vitit akademik.

4. Në rast se IAL-së i pezullohet licenca, ai ka detyrimin për të ndërmarre masat e duhura për rimbursimin e studentëve dhe transferimin e tyre në institucione të tjera të arsimit të lartë, që ofrojnë të njëjtat programe studimi. Ky informacion bëhet publik dhe pasqyrohet në dokumentin mbi performancën e shkollës.

5. Transferimi i studentëve do të kryhet sipas procedurave të parashikuara në udhëzimin e Ministrit për transferimin e studimeve.

6. Gjatë periudhës së pezullimit të licencës, IAL nuk do të regjistrojë më studentë në programet e tij të studimit.

C. Procedurat në rast likuidimi të IAL-së

1. Një institucion i arsimit të lartë privat në gjendjen e aftësisë pagueuse mund të likuidohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

2. Vendimin për likuidimin e një IAL-je private e Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë pas konsultimit me senatin e IAL-së. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet menjëherë MASH-it.

3. Procedurat do të kryhen nga një likuidues i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Likuiduesi do të marrë të gjitha kompetencat e organeve të IAL-së private.

4. Programet e studimit që kanë filluar para çeljes së procedurave të likuidimit do të vazhdojnë të ofrohen deri në fund të vitit akademik në të cilin ka filluar procedura e likuidimit.

5. Likuidimi mund të kryhet vetëm pasi të jenë marrë të gjitha masat që studentët të vazhdojnë studimet. Pronat dhe pasuritë e një IAL-je do të përdoren për të shlyer të gjitha detyrimet që IAL-ja ka ndaj kreditorëve të tij, ku në radhë të parë janë studentët dhe personeli akademik.

6. Gjatë gjithë kohëzgjatjes së procedurave të likuidimit IAL-ja private nuk do të hapë programe të reja dhe nuk do të regjistrojë studentë të rinj.

7. Likuiduesi i IAL-së ka detyrimin të njoftojë MASH-in për përfundimin e procedurave të likuidimit.

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Kërkesat për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, të dorëzuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 307, datë 22.7.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar pozitivisht nga komisionet e vlerësimit, sipas dispozitave të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, për licencim.

2. Kërkesat për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, të dorëzuara para hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 307, datë 22.7.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilat nuk janë shqyrtuar ose vlerësuar nga komisioni i veçantë, do të shqyrtohen me prioritet, sipas kritereve dhe procedurave, të përcaktuara në këtë udhëzim. Afati i fillimit të procedurave do të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi.

3. Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, nr.30, datë 26.9.2007 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit që duhet të paraqesë subjekti juridik, për hapjen e një institucioni privat të arsimit të lartë ose programeve të studimit, në ciklin e parë, ciklin e dytë dhe ciklin e tretë të studimeve, si dhe programeve të studimeve jouniversitare të natyrës profesionale”, të ndryshuar, shfuqizohet.

4. Afati i aplikimit për vitin 2011 shtyhet deri më 15 prill 2011.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

SHTOJCA 1

Formulari Aplikimi

* Lutemi të përdorni PC për plotësimin e këtij formulari, përveç aty ku duhet nënshkruar.

<p><u>GJENERALITETET</u></p> <p>Emri: _____</p> <p>Emri i babait: _____</p> <p>Mbiemri: _____</p> <p>Data e lindjes: _____</p> <p>Vendlindja: _____</p> <p>Adresa: _____</p> <p>_____ Vendbanimi: _____</p> <p>Telefon: _____</p> <p>Celular: _____</p>	<p>Shënime të grupit/personit të verifikimit:</p> <p>I. Data e Protokollimit: _____</p> <p>II. Nr. i Protokollit. _____</p> <p>III. Nr. i Aplikantit: _____</p>
<p><u>Institucioni:</u></p> <p>Emërtimi _____</p> <p>Adresa _____</p> <p>Telefon _____</p> <p>Posta-elektronike _____</p>	<p>V. Data e kontrollit/DZHA P _____</p> <p>IV. Emri /Mbiemri _____</p> <p>VI. Firma Drejt. /DZHAP _____</p>
<p><u>APLIKIM për:</u></p> <p><input type="checkbox"/> Shkollë të lartë <input type="checkbox"/> Kolegj profesional <input type="checkbox"/> Akademi</p> <p><input type="checkbox"/> Hapje programi <input type="checkbox"/> Cikli I <input type="checkbox"/> Cikli II <input type="checkbox"/> Prog. të integruara-Cikli II</p> <p><input type="checkbox"/> Riorganizim</p>	<p>VII. Adresa e sakte Po/Jo. _____</p> <p>VIII. APAAL/ Data: _____</p>
<p><u>Kërkesë të veçantë:</u></p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>	<p>1. _____</p> <p>2. _____</p> <p>3. _____</p>

AUTODEKLARIM

Unë i/e nënshkruari/a

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

1. Të gjitha të dhënat janë të vërteta dhe jam i gatshëm t'i nënshtrohem verifikimit nga organet përkatëse për të gjithë informacionin e paraqitur si më sipër.
2. Jam i regjistruar me ekstrakt QKR-je si person juridik, me të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në fushën përkatëse të arsimit privat, me nr. _____, datë _____ ;
3. Kam vërtetim pronësie nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, nr. _____, datë _____ deklaroj për sigurimin e një mjedisi të përshtatshëm për realizimin e procesit mësimor.
4. Nuk jam në proces gjykimi, hetimi, apo të jem i dënuar në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin.
5. Do të plotësoj gjithë standardet akademike të institucioneve private të arsimit të lartë.
6. Do të plotësoj kërkesat e Vendimit Nr. 285, datë 04.05.2007 të Këshillit të Ministrave "PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS REFERUESE MUJORE, PËR EFEKT TË LLOGARITJES SË KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE DHE TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE...." në lidhje me pagesën e personelit akademik.
7. Do të plotësoj të gjitha standardet teknike të vendosura nga ky udhëzim për objektin shkollor (SHTOJCA 3).

IX. KA/Data:

1. _____

X:

Miratuar PO/JO: _____

XI. Data e urdhërit Min: _____

XII. Data dërguar subjektit: _____

XII. Data e Arkivimit: _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Datë, Emër, Mbiemër_____
Nënshkrimi

SHTOJCA 2

SHTOJCA (NR. 2) E UDHËZIMIT PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

A. Një institucion i arsimit të lartë që kërkon të licencohet apo të hapë programe të reja studimi, duhet të plotësojë këto standarde të organizimit dhe personelit:

1. Një institucion privat i arsimit të lartë organizohet në njësi përbërëse kryesore: fakultete, njësi kërkimi e zhvillimi apo kolegje e filiale; njësi bazë: departamente e qendra kërkimi; njësi ndihmëse: laboratorë, qendra eksperimentale, biblioteka, dhe njësi shërbimi, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë duke respektuar kategorizimin e institucionit.

a) Institucioni duhet të ketë të paktën dy fakultete, ku secili mund të ofrojë programe studimi të llojeve dhe niveleve të ndryshme.

b) Çdo fakultet duhet të ketë të paktën tri njësi bazë, që grupojnë disiplina mësimore të përafërta ose të ndërthurura dhe që përfshijnë fusha kërkimi respektive.

c) Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre duhet të jenë me gradë shkencore dhe/apo titull akademik.

2. Institucionet private të arsimit të lartë që fillojnë aktivitetin e tyre dhe që janë në vitin e parë të studimeve, duhet të propozojnë një personel akademik të mjaftueshëm për të paktën vitin e parë të studimeve, por ata mbartin detyrimin që të raportojnë e të miratojnë çdo vit në MASH personelin e ri që rekrutojnë për vitet shkollore në vijim, deri në plotësimin e tij në përputhje me kriteret e pikës 1.

3. Një institucion privat i huaj i arsimit të lartë apo filial i tij, që zotëron një formë akreditimi në një shtet tjetër, mund të ketë organizim tjetër strukturor nga ai i pikës 1.

4. Raporti personel akademik (i brendshëm + i jashtëm) student duhet të jetë rreth 1:20.

5. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë rreth 2/3 të ngarkesës mësimore për lëndët e detyrueshme për çdo program studimi.

6. Rektori dhe dekanët duhet të jenë personel akademik efektiv i institucionit.

7. Institucioni duhet të parashikojë ngritjen dhe funksionimin në mënyrë demokratike të organeve kolegjinale për vendimmarrjen akademike që lidhet me çështjet e programeve të studimit, kriteret e pranimit të studentëve etj.

8. Institucioni duhet të ketë mjedise mësimore të mjaftueshme dhe të pajisura me infrastrukturë, fasilite dhe mjete audiovizive mësimdhënëse bashkëkohore.

9. Programet e studimit të paraqitura në projektin e licencimit duhet të plotësojnë kriteret e paraqitura në kreun B dhe C të këtij aneksi.

B. Një institucion privat i licencuar i arsimit të lartë, që kërkon hapjen e programeve të reja të studimit të ciklit të parë, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të përcaktojë qartë emërtimin dhe formën e studimit për çdo program studimi që kërkon;

2. Programet e studimit të propozuara duhet të organizohen në module dhe të vlerësohen në kredite sipas sistemit europian ECTS; në ato raste kur institucioni operon sipas një sistemi tjetër kreditimi, duhet të qartësojë ekuivalentimin e këtij sistemi në atë ECTS.

3. Programet e studimit të ciklit të parë, të hartuara sipas ligjit për arsimin e lartë, zgjatin:

a) tri vite studimi dhe realizohen me së paku 180 kredite kur janë programe universitare.

b) Dy vite studimi dhe realizohen me së paku 120 kredite kur janë programe jouniversitare.

Kur punohet me modele të tjera, subjekti kërkues duhet të paraqesë ekuivalentimet përkatëse.

4. Planet mësimore për çdo program studimi duhet të parashikojnë modulet dhe lëndët përkatëse, ngarkesën mësimore për çdo modul/lëndë në auditor dhe jashtë auditorit, format e mësimdhënies, si: leksion, ushtrime, seminare, laborator, projekt dhe raportet midis tyre sipas natyrës së programit, ngarkesën në kredite për çdo modul/lëndë dhe syllabusin e çdo lënde.

5. Njësinë akademike dhe personelin akademik përgjegjës për çdo program studimi të propozuar, si dhe lëndët që parashikohet të mbulojë çdo anëtar i personelit akademik.

6. Një kredit ECTS duhet të barazohet me rreth 25 orë mësimore gjithsej, nga të cilat rreth 10-12 orë mësimore në auditor dhe pjesa tjetër për studim individual.

7. Në përfundim të programeve të ciklit të parë, duhet të lëshohet diplomë *Bachelor*.

8. Institucioni duhet të paraqesë emërtimin dhe modelin e diplomës që parashikon të lëshojë në fund të programit të studimit.

9. Diploma duhet të shoqërohet me suplementin e diplomës së përgatitur sipas standardeve europiane.

10. Në statutin dhe rregulloret e institucionit duhet të paraqiten kushtet dhe kriteret e pranimit dhe/ose të përzgjedhjes (nëse ka) në çdo program studimi, metodat dhe format e vlerësimit të studentëve, si dhe kushtet, kriteret e procedurat për lëvizjen nga një program në tjetrin dhe të transferimit.

11. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinore apo të përbashkëta, të tregohen institucionet bashkëpunuese dhe emërtimi i diplomës.

12. Në rastet e programeve të studimit për formim të vazhduar, të paraqitet forma e organizimit, kushtet dhe kriteret e pranimit dhe lloji e modeli i certifikatës që do të lëshohet.

C. Një institucion i arsimit të lartë privat, që kërkon hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

1. Të përcaktojë qartë emërtimin dhe formën e studimit për çdo program studimi që kërkon:

2. Programet e studimit të propozuara duhet të organizohen në module dhe të vlerësohen në kredite sipas sistemit europian ECTS; në ato raste kur një institucion operon sipas një sistemi tjetër, duhet të qartësojë ekuivalentimin e këtij sistemi në atë ECTS.

3. Programet e studimit të ciklit të dytë zgjasin përkatësisht:

a) dy vite akademike (120 kredite) për programet e studimit të ciklit të dytë, në fund të të cilës lëshohet diplomë e nivelit “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”;

b) 1,5 vit akademik (60-90 kredite) për programet e studimeve “Master profesional”, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Master profesional”;

c) pesë vite akademike (300 kredite), duke përfshirë dhe studimet e ciklit të parë, për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura”.

4. Planet mësimore për çdo program studimi duhet të parashikojnë modulet dhe lëndët përkatëse, ngarkesën mësimore për çdo modul/lëndë në auditor dhe jashtë auditorit, format e mësimdhënies, si: leksion, ushtrime, seminare, laborator, projekt dhe raportet midis tyre sipas natyrës së programit, ngarkesën në kredite për çdo modul/lëndë dhe syllabusin e çdo lënde.

5. Njësinë akademike dhe personelin akademik përgjegjës për çdo program studimi të propozuar, si dhe lëndët që parashikohet të mbulojë çdo anëtar i personelit akademik.

6. Përgjegjësit e çdo lënde/moduli, të cilët duhet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor”.

7. Institucioni duhet të ketë kriteret përzgjedhjeje për studentët që do të pranohen në programet e studimit të ciklit të dytë, të cilat bëhen publike.

8. Në statutin dhe rregulloret e institucionit duhet të paraqiten kriteret e pranimit, si programet e studimit që duhet të kenë përfunduar studentët për t’u pranuar në çdo program studimi të ciklit të dytë që ofrohet, metodat dhe format e vlerësimit të studentëve, si dhe kushtet, kriteret e procedurat për lëvizjen nga një program në tjetrin dhe të transferimit.

9. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinore apo të përbashkëta, të tregohen institucionet bashkëpunuese.

10. Për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i shkencave”, institucioni kërkues duhet të zotërojë burime materiale (laboratorë, mjedise të posaçme, teknologji, literaturë) për të kryer formim të avancuar të studentëve, në funksion të programeve të kërkuara, si dhe personel akademik të mjaftueshëm e të specializuar në fushën përkatëse.

11. Për programet e studimeve “Master profesional”, institucioni duhet të zotërojë burime materiale (laboratorë, mjedise të posaçme, teknologji), personel akademik të mjaftueshëm e të specializuar, si dhe mundësi për studentët për të kryer praktikën pranë institucioneve publike apo private në varësi të programeve të kërkuara.

12. Personeli akademik i angazhuar në programet e studimit të ciklit të dytë duhet të ketë gradë shkencore apo/dhe tituj akademikë; të paktën 70% e personelit akademik përgjegjës për programin e kërkuar, duhet të jetë i punësuar efektiv në institucion, me përjashtim të rasteve kur programet e studimit ofrohen në bashkëpunim zyrtar me institucionet apo filiale të një institucioni të huaj të arsimit të lartë.

13. Raporti personel akademik (i brendshëm + i jashtëm) studenti duhet të jetë rreth 1:20.

14. Institucioni duhet të paraqesë emërtimin dhe modelin e diplomës që parashikon të lëshojë në fund të kursit të studimit për çdo program studimi.

15. Diploma duhet të shoqërohet me suplementin e diplomës, të përgatitur sipas udhëzimit të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, nr.12, datë 14.5.2007 “Për akordimin e “Shtojcës së diplomës” (suplementit të diplomës) nga të gjitha shkollat e larta”.

SHTOJCA 3

SHTOJCA (NR.3) E UDHËZIMIT PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

STANDARDE (MINIMALE) DHE NORMATIVA PËR INFRASTRUKTURËN E INSTITUCIONEVE PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË

Standardet normative për objektet që do të funksionojnë si institucione private të arsimit të lartë, do të jenë:

1. Objektet e arsimit të lartë privat duhet të jenë objekte të ndërtuara (ose rikonstruktura) me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin (rikonstruksionin) e objektit, nuk duhet të kenë në përbërjen e tyre elemente të dëmshme për shëndetin e studentëve dhe personelit. Materialet dhe teknologjia e punimeve duhet të sigurojnë akustikë të mirë në ambientet e mësimi dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave, luhatjeve të temperaturës dhe lagështirës.

2. Objektet e arsimit të lartë privat duhet të jenë të vendosura larg zonave të zhvillimit industrial, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara sipas standardeve përkatëse.

3. Objektet që do të përdoren për hapjen e institucioneve private të arsimit të lartë, detyrimisht duhet të përmbajnë minimalisht ambientet sipas natyrës dhe funksionit si më poshtë:

a) Auditorë mësimi;

b) Ambiente për laboratorë;

c) Ambiente për personelin pedagogjik;

d) Ambiente për personelin administrativ;

e) Ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, kompjuterash, multimedia etj., të kësaj natyre;

f) Ambiente teknike (që i shërbejnë funksionit të godinës, si: kaldaja, motor gjeneratori, depozita uji dhe elektropompa, depo, kabina elektrike etj.), oborr dhe ambiente të gjelbëruara.

4. Objektet që do të ofrohen për institucionet e arsimit të lartë privat, detyrimisht, duhet të plotësojnë normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme (për ambientet e përshkruar në pikën 3) prej 3,8 – 4.0 m²/student (minimumi) dhe 7.5–8.0 m²/student (maksimumi). Lartësia e ambienteve duhet të jetë jo më e vogël se 3.0 m (tavan – dysHEME). Normativa minimale e mësipërme do të pranohet për programe studimi, të tilla si: gjuhë, letërsi, sociologji, histori, gjeografi, shkencat ekonomike, juridik, matematikë, arkeologji etj. (të kësaj natyre, përgjithësisht për shkencat shoqërore e politike), kurse për programe studimi, si:

arkitekturë, muzikë etj. (të kësaj natyre) do të pranohen normativa jo më pak se niveli mesatar më sipër. Për programe studimi inxhinierike apo të shkencave të natyrës (fizikë, kimi, biologji etj.) normativat e mësipërme, minimalisht, do të dyfishohen (minimumi dhe maksimumi). Në këto normativa nuk parashikohen sipërfaqet e nevojshme për ambientet kërkimore e shkencore.

5. Nyjat hidro-sanitare duhet të parashikohen 1 boks dhe lavaman për 35-40 djem, 1 boks dhe lavaman për 30 vajza, si edhe 1 boks dhe lavaman për administratën, mundësisht edhe ujë të ngrohtë.

6. Në ambientet e mësimi, objekti duhet të plotësojë normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve duhet të mbulojë minimalisht (15-20)% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë i orientuar nga krahu i majtë i studentit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi duhet të realizohet nga dritare (rekomandohet me dopio xham) të tejdukshëm.

7. Numri i studentëve në grupet e seminareve dhe ushtrimeve do të jetë 20-25 studentë (maksimumi 30 studentë), grupi i studentëve për laboratorë 12-15 studentë, për leksionet jo më pak se 80 studentë dhe për praktikat e stazhit jo më pak se 15 studentë.

8. Objektet e arsimit të lartë privat me më shumë se 200 studentë (në një godinë), detyrimisht duhet të jenë të pajisur me dalje dhe shkallë emergjence.

9. Të gjitha objektet që do të shërbejnë si institucione private të arsimit të lartë, duhet të kenë të instaluar sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit ose të jenë kompletuar (sipas normativave përkatëse) me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundër zjarrit, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

10. Institucionet private të arsimit të lartë duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë shëndetësore (ose ambient) dhe mjetet e pajisjet e nevojshme për këtë qëllim.

11. Objektet private të arsimit të lartë duhet të kenë të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike (motogenerator etj.), si edhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm.

12. Ambientet e mësimi, detyrimisht duhet të jenë të kompletuara dhe të funksionojë sistemi i ngrohjes.

SHTOJCA 4

SHTOJCA (NR.4) E UDHËZIMIT PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PARAQESË SUBJEKTI JURIDIK, PËR HAPJEN E NJË INSTITUCIONI PRIVAT TË ARSIMIT TË LARTË OSE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, NË CIKLIN E PARË DHE CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE

Kërkesat minimale për kontratën ndërmjet studentit dhe IAL-së

Kontrata ndërmjet studentit/es dhe IAL-së të përmbajë:

1. Emrin e institucionit dhe emërtimin e programit të studimit, duke përfshirë sasinë e krediteve për çdo program studimi, orët e mësimi ose elemente të tjera të domosdoshme për të përfunduar programin e studimit.

2. Një grafik të të gjitha pagesave, duke përfshirë pagesat e rimbursueshme dhe ato të parimbursueshme.

3. Në fletën e kontratës ku do të hidhet firma e studentit të paraqiten qartë:

i) Tarifa e plotë e programit të studimit dhe format e kryerjes së pagesës (këstet, modalitetet e pagesës etj.);

ii) Pagesa që studenti bën në momentin e regjistrimit;

iii) Këstet e pagesës të ndahen në mënyrë të tillë që studenti të paguajë paraprakisht deri në 50% të pagesës për semestër;

iv) Deklarim të qartë se kontrata është ligjërish e detyrueshme nëse nënshkruhet nga studenti dhe pranohet nga institucioni;

v) Një klauzolë ku të shprehet qartë e drejta e studentit për të hequr dorë nga kontrata, në të cilën duhet sqaruar se: studentit ka të drejtë të heqë dorë nga kontrata dhe t'i rimbursohen plotësisht pagesat e bëra për ndjekjen e orës së parë të mësimi ose 7 ditë pas nënshkrimit të kontratës së regjistrimit, cilado prej këtyre datave të jetë më e vonshme;

vi) Rregullat e institucionit për rimbursimin;
vii) Procedura që duhet të ndjekë studenti për të ndërprerë kontratën ose rimbursimin e pagesave të bëra.

4. Kontrata të shoqërohet me një dokument mbi performancën e shkollës.

5. Deklarata, për sa më poshtë:

a) Përpara nënshkrimit të kontratës, studenti ka të drejtë të kërkojë t'i paraqitet një katalog apo broshurë mbi performancën e shkollës, të cilën ai/ajo duhet ta studiojë përpara nënshkrimit të kontratës. Ky dokument përmban të dhëna të rëndësishme mbi politikën dhe performancën e institucionit. Dokumenti duhet nënshkruar nga studenti me datën përkatëse, për të vërtetuar që ai/ajo ka dijeni paraprakisht mbi përqindjen kaluese për programin e studimit dhe përqindjen e kaluesve në provimin e shtetit apo numrin e të licencuarve.

b) Për pyetje të tjera në lidhje me kontratën, të cilat sipas studentit nuk janë trajtuar mjaftueshëm nga institucioni, mund t'u drejtohen instancave përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë (adresa e plotë e drejtorisë përgjegjëse, numri i telefonit të zyrës dhe faqja e internetit).

c) Studenti apo çdo person publik ka të drejtë të ankohet për institucionin, duke kontaktuar direkt instancat përgjegjëse pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, duke telefonuar (numrin e telefonit) ose duke plotësuar letrën e ankesës që mund të shkarkohet në faqen e internetit (adresa e plotë e faqes së internetit).

d) Të përfshihet në faqen ku do të nënshkruajë studenti: "Unë deklaroj se e kuptoj që kjo kontratë është e detyrueshme. Nënshkrimi im i mëposhtëm dëshmon se unë e kam lexuar, kuptuar dhe kam rënë dakord bazuar mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e mia, si dhe që rregullat e ndërprerjes së kontratës dhe të rimbursimit më janë shpjeguar më së miri."

e) Kontrata, dokumenti mbi performancën e shkollës të firmosen dhe t'i vendoset data nga studenti.

SHTOJCA 5

Datë _____

LETËR ANGAZHIMI

Në zbatim të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", (të ndryshuar me ligjet nr.9832, datë 12.11.2007 dhe nr.10 307, datë 22.7.2010); neni 50 "Punësimi në institucionet e arsimit të lartë", pika 1.1 "Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në një institucion të arsimit të lartë, publik ose privat, ka të drejtë, me miratimin e titullarit të njësisë kryesore dhe të institucionit të arsimit të lartë, të angazhohet si personel akademik i ftuar me kohë të pjesshme, në një institucion tjetër të arsimit të lartë, publik ose privat, brenda dhe jashtë vendit",

Unë, i nënshkruari _____ me titull akademik _____, lëshuar nga universiteti _____ më _____, i punësuar si _____ pranë _____ angazhohem me përgjegjësinë time të plotë pranë IAL-së private _____ me kohë të plotë / pjesshme.

Vendi _____ Datë _____ Nënshkruesi (firmë)	Firma (vula) e punëdhënësit
--	-----------------------------

Leja nga punëdhënësi kryesor
(Për punëmarrësit e angazhuar në një tjetër institucion të arsimit të lartë me kohë të plotë.)

Institucioni	Rektori (Emër mbiemër) (Firmë) (vula)
Fakulteti	
Dekani (firmë)	

VENDIM
Nr.83, datë 25.2.2011

MBI HEQJEN E LICENCËS SË TELEVISIONIT PRIVAT VENDOR “TELE 1”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	Kryetar
Alban Karapici	Zëvendëskryetar
Gent Ibrahim	Anëtar
Suela Musta	Anëtare
Sami Neza	Anëtar
Zylyftar Bregu	Anëtar

pasi mori në shqyrtim, sot në datë 25.2.2011, çështjen me:

Objekt: Mbi heqjen e licencës së televizionit privat vendor “Tele 1”

Baza ligjore: Neni 7, pika 21, neni 34, pika 5 dhe neni 137 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

Në bazë të nenit 7, pika 2 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për periudhën 1 prill-15 dhjetor 2010, sektori i monitorimeve pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, nga monitorimet e kryera, ka konstatuar se transmetimet e programeve të këtij televizioni kanë pasur ndërprerje të shpeshta.

Sipas aktit të monitorimit, transmetuesi i televizionit “Tele 1”, i vendosur në pikën Fushë-Dajt ka qenë i fikur si vijon:

- në muajin prill, 6 ditë;
- në muajin gusht, 21 ditë;
- në muajin shtator, 5 ditë;
- në muajin tetor, 5 ditë;
- në muajin dhjetor, 3 ditë.

Për sa më sipër, KKRT-ja me shkresën nr.18 prot., datë 7.1.2011 filloi hetimin administrativ ndaj subjektit televiziv privat vendor “Tele 1”, duke kërkuar nga ky i fundit që të paraqesë arsyet e ndërprerjeve të sipërpërmendura të transmetimit.

Në datën 11.1.2011, subjekti “Tele 1” ka dërguar shkresën me nr.150 në përgjigje të fillimit të hetimit administrativ nga ana e KKRT-së. Ndër të tjera, subjekti parashtron se:

“...Në fillim të vitit kemi ndërprerë transmetimin për dy ditë, për arsye të rinovimeve teknologjike. Dy herë ka pasur goditje të tensionit të lartë që kanë shkaktuar djegien e aparaturave tona transmetuese dhe janë rregulluar brenda ditës. Në muajin gusht, si pasojë e nxehtësisë dhe tensionit, kemi pasur një djegie të aparaturave transmetuese dhe kjo periudhë nuk ka zgjatur më tepër se një javë. Ritheksojmë që ne nuk mendojmë që kemi plotësuar limitin prej 30 ditëve në vit. Megjithatë tani aparaturat tona të transmetimit janë krejtësisht të reja dhe ne kemi marrë masa më të forta preventive dhe defekte të tilla nuk kanë për t’u përsëritur më. ”

Lidhur me pretendimet e mësipërme, KKRT-ja konstaton se:

Subjekti televiziv “Tele 1” nuk e mohon ndërprerjen e transmetimit, por paraqet arsyet e këtyre ndërprerjeve. Ky subjekt nuk ka njoftuar asnjëherë KKRT-në për arsyet e ndërprerjes së transmetimit. Sektori i monitorimit të frekuencave në KKRT, ndër të tjera, ka detyrën e matjeve ditore të transmetimeve radio e televizive të rajonit të Tiranës. Ky inspektim kryhet nga inspektorët dhe regjistrohet çdo ditë në një dokument të veçantë, të quajtur akt inspektimi.

Televizioni “Tele 1” nuk ka transmetuar programe për 40 ditë gjatë periudhës 1 prill-15 dhjetor 2010. Sipas nenit 34, pika 5 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Këshilli Kombëtar i Radiotelevizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur...5. pas fillimit të transmetimit gjatë një viti kalendarik nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës.”

Po ashtu, nga inspektimet ditore të kryera në qytetin e Tiranës, rezulton se për periudhën 2-mujore: 4 janar-16 shkurt 2011, stacioni televiziv i operatorit TV “Tele 1” i vendosur në pikën transmetuese Fushë-Dajt, ka emetuar sinjal televiziv analog në mënyrë të pandërprerë. Për këtë periudhë monitorimi, specialistët e Drejtorisë Teknike kanë konstatuar se ky operator vazhdon të transmetojë në kanalin CH 68 të brezit UHF. Subjekti nuk ka transmetuar programe, por vetëm logon e tij.

Subjekti televiziv privat vendor “Tele 1” është sanksionuar edhe më parë nga ana e KKRT-së për shkelje të strukturës programore, për të cilën është licencuar nga KKRT-ja. Konkretisht, me vendimin e KKRT-së nr.190, datë 22.10.2010 “Për miratimin e sanksionit të paralajmërimit ndaj subjektit televiziv privat vendor “Tele 1” është vendosur sanksioni i paralajmërimit, ndërsa me vendimin nr.48, datë 21.1.2011 “Për reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës së televizionit privat vendor “Tele 1” është vendosur reduktimi i licencës së subjektit nga 5 vjet në 2 vjet e gjysmë.

Edhe pas vendosjes së këtyre sanksioneve, rezulton se subjekti vazhdon të mos i përmbahet strukturës programore për të cilën është licencuar nga KKRT-ja. Konkretisht, nga monitorimi i këtij operatori, për periudhën 16.2.2011-21.2.2011, ka rezultuar se gjatë gjithë periudhës së regjistrimit, ky subjekt ka ndryshuar logon, duke transmetuar vetëm këtë të fundit dhe shënimin poshtë saj “prova teknike”. Në pjesën më të madhe të ditëve të periudhës janar-shkurt, ky operator nuk ka transmetuar programe, por vetëm logon.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7, pika 21, neni 34, pika 5 dhe neni 137, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Heqjen e licencës nr.031/TVL të televizionit privat vendor “Tele 1”.
2. Subjekti ka të drejtë që brenda 30 ditësh të parashtojë pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

Pretendimet e mbështetura të subjektit do të diskutohen në mbledhjen më të afërt të KKRT-së, ku pas dëgjimit do të jepet vendimi përfundimtar.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.86, datë 10.3.2011

PËR NDRYSHIMIN E PIKËS 2 TË DISPOZITIVIT TË VENDIMIT TË KKRT NR.83,
DATE 25.2.2011

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	Kryetare
Alban Karapici	Zëvendëskryetar
Gent Ibrahim	Anëtar
Suela Musta	Anëtare
Sami Neza	Anëtar
Zylyftar Bregu	Anëtar, në mungesë

Pasi mori në shqyrtim sot në datën 10.3.2011 çështjen me:

Objekt: Mbi ndryshimin e pikës 2 të dispozitivit të vendimit të KKRT-së nr.83, datë 25.2.2011.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 18 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Në vendimin e KKRT-së nr.83, datë 25.2.2011 është vendosur “Heqja e licencës së televizionit privat vendor “Tele 1”, me nr.031/TVL”.

Nga shqyrtimit i dispozitivit të vendimit të KKRT-së rezulton se subjekti televiziv privat vendor “Tele 1” (më poshtë subjekti “Tele 1”) është orientuar gabim, që ankimin e tij ta paraqesë në KKRT, dhe jo në Gjykatë. Për ta sqaruar këtë gabim, është e nevojshme të analizohet legjislacioni që lidhet me procedurat e heqjes së licencës së subjektit.

Më konkretisht, ndaj subjektit “Tele 1” për shkak të shkeljeve të parashikuara nga neni 34/5 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, KKRT-ja nisi një procedurë administrative, në përfundim të të cilës, me vendimin nr.83, datë 25.2.2011, vendosi “heqjen e licencës së televizionit privat vendor “Tele 1”.

Baza ligjore që parashikon procedurat që ndiqen në këtë rast parashikohen nga neni 137/3 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit:

“Kur inspektorët e KKRT-së vërtetojnë se i licencuari ka shkelur dispozitat e këtij ligji, kushtet e licencës dhe rregulloret e miratuara nga KKRT-ja, kanë të drejtë:

...

3. t'i propozojë KKRT-së pezullimin e përkohshëm të licencës, reduktimin e kohës së vlefshmërisë së licencës ose heqjen e saj.”

Sa më sipër, rezulton të jetë respektuar në rastin konkret, pasi me shkresën e datës 20.1.2011, Drejtoria Teknike në KKRT ka informuar për shkeljet e ligjit dhe më pas ky propozim i është përcjellë KKRT-së për miratim.

Në lidhje me procedurën e dhënies së prapësimeve të subjektit ndaj të cilit merret seksioni, po neni 137/3 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon që:

“Për t’i dhënë të licencuarit mundësi të japë mendime, para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen e licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi”.

Nëse edhe pas dëgjimit të të licencuarit, KKRT-ja e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje. KKRT-ja e boton vendimin në Fletoren Zyrtare në numrin më të afërt të saj dhe në buletin e vet.

Neni i mësipërm në praktikë nga KKRT-ja është interpretuar në mënyra të ndryshme. Kështu, ka pasur raste kur ky nen është interpretuar sikur KKRT-ja është e detyruar të marrë dy vendime (praktikë e ndjekur kjo veçanërisht në rastet e rinovimit të licencave). Jemi të mendimit se ky interpretim nuk është i saktë për arsyet e mëposhtme:

1. Marrja e dy vendimeve nga i njëjti organ, për të njëjtën çështje paraqet disa probleme:

a) Sipas nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative (seksioni IV “Përfundimi i procedimit administrativ”), procedimi mbyllet me marrjen e vetëm një vendimi.

b) Në ndryshim nga Kodi i Procedurës Civile, ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar nuk parashikon as vendimin e ndërmjetëm, dhe as ndonjë lloj tjetër vendimi paraprak.

c) Shqyrtimi i ankimit për shfuqizimin e vendimit nga i njëjti organ që ka dhënë vendimin, nuk është në harmoni me parimet e përgjithshme të së drejtës administrative, pasi shqyrtimi i ankimit për shfuqizimin e vendimit të një organi administrativ bëhet: ose nga organi epror, ose (në rastin tonë) nga një organ tjetër (gjykata).

2. Nëse ndalemi në terminologjinë apo procedurat e parashikuara nga neni 137/3 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka disa paqartësi. Kështu neni parashikon që:

a) “...para marrjes së vendimit për ndalimin, reduktimin ose heqjen licencës, KKRT-ja njofton të licencuarin për vendimin dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi”. Paqartësia qëndron në faktin se nëse nuk është marrë vendimi, ai nuk mund t’i dërgohet të licencuarit, ose të paktën ajo që i dërgohet të licencuarit, duhet të emërohej projektvendim apo vendim paraprak.

b) “Nëse edhe pas dëgjimit të të licencuarit KKRT-ja e miraton marrjen e vendimit, ai i jep të licencuarit një kopje”. Sipas kësaj fjalie rezulton që kopja jepet vetëm në rast të miratimit të vendimit, pra ndryshe nga sa u tha më sipër, që kopjoja i ishte dërguar paraprakisht subjektit.

3. Për vetë paqartësitë e mësipërme, por edhe për faktin se ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk parashikon procedura specifike për procedimet/hetimet administrative në rastet e heqjes së licencave, KKRT-ja në zbatimin e këtij neni është bazuar edhe në rregullat e përcaktuara nga Kodi i Procedurave Administrative. Më konkretisht:

a) KKRT-ja ka zhvilluar hetimin administrativ;

b) gjatë dhe pas të cilit të licencuarit i është dhënë mundësia të shprehë pretendimet e tij;

c) në përfundim, KKRT-ja ka marrë vendimin përkatës.

4. Në lidhje me termin “dëgjim” nga ana e KKRT-së ekziston tashmë një praktikë e konsoliduar, që dëgjimi realizohet nëpërmjet paraqitjes me shkrim të pretendimeve nga ana e subjektit, dhe jo e paraqitjes me gojë të këtyre pretendimeve. Ky interpretim është bazuar në:

a) statusin që ka KKRT-ja (si organ administrativ) dhe duke qenë se dëgjimi është një proces që merr rol të veçantë kur bëhet nga organe gjyqësore (pra, kur dy palë paraqesin pretendimet e tyre përpara një organi të tretë që merr vendimin), paraqitja e pretendimeve me gojë, mund të vinte KKRT-në në rolin e palës;

b) procedurat e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, ku neni 94 i të cilit i njej të drejtën subjektive që t'i bashkëngjisin dokumente shpjegimeve të tyre, apo edhe të kërkojnë marrjen e masave të tjera që ata i gjykojnë të nevojshme;

c) aspektin praktik, ku pretendimet e paraqitura nga subjektet shqyrtohen paraprakisht nga administrata e KKRT-së (drejtoritë e ndryshme sipas problematikës së ngritur) dhe konkluzionet e këtyre drejtorive i paraqiten KKRT-së nëpërmjet relacioneve përkatëse. Pra, në praktikë “dëgjimi” bëhet nëpërmjet shqyrtimit të pretendimeve me shkrim që ka sjellë paraprakisht i licencuari dhe nuk është e nevojshme që KKRT-ja të mblidhet dy herë (një herë për të dëgjuar pretendimet me gojë - t’ia përcjellë këto pretendime drejtorive të KKRT-së, dhe më pas të rimblidhet për të shqyrtuar relacionet e drejtorive.

Jemi të mendimit se praktika e mësipërme përmbush më së miri qëllimin e legjislatorit, që ka dashur t’i garantojë subjektit të drejtën e dhënies së pretendimeve, prapësimeve apo mendimeve të tij.

5. Së fundi, po jo për nga rëndësia, për vetë referimet që iu bënë më sipër Kodit të Procedurave Administrative, do të donim të sqaronim raportin ndërmjet këtij Kodi dhe ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në rastet e paqartësive (siç është rasti i nenit 137/3 të cituar më sipër).

Nëse i referohemi praktikës gjyqësore, në disa vendime të saj Gjykata Kushtetuese (vendimi nr.19, datë 3.5.2007, vendimi nr.2, datë 3.2.2010, vendimi nr.9, datë 23.3.2010), ka ritheksuar hierarkinë dhe vlefshmërinë e normave me fuqi juridike të ndryshme, siç është rasti i kodeve dhe i ligjeve të zakonshme:

Sipas vendimeve të mësipërme, duhet të kihet parasysh raportet ndërmjet ligjeve që miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligje me shumicë të cilësuar, parashikuar nga neni 81/2 i Kushtetutës) dhe ligjeve që miratohen sipas rregullit të përgjithshëm (të parashikuara nga neni 78 i Kushtetutës). Kushtetuta shqiptare i jep ligjeve që miratohen me shumicë të cilësuar fuqi të veçantë juridike, në krahasim me aktet e zakonshme të miratuara nga ligjvënësi. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve normative, ato renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit.

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë, ka epërsi në raport me normën tjetër (*lex superior derogat inferiori*). Parimet se norma specifike ka përparësi nga norma e përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë, ka përparësi nga norma e mëparshme, nuk veprojnë në raste të tilla.

Pra, nga sa më sipër, jemi të mendimit që në rastet kur ka paqartësi në ligjin organik, prioritet do të ketë zbatimi i rregullave të Kodit të Procedurave Administrative. Vendimet e mësipërme të Gjykatës Kushtetuese, vendime të cilat kanë vlerë *erga omnes*, e shprehin qartë se në rast konflikti me dy normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë (Kodi i Procedurave Administrative në rastin konkret), ka epërsi ndaj një ligji të zakonshëm (ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar). Prandaj për përcaktimin se cili ligj do të zbatohet në rastin konkret, mendojmë që nuk ka asnjë diskutim që prioritet ka Kodi i Procedurave Administrative.

Për gjithë sa më sipër, në bazë të neneve 18 dhe 128 të Kodit të Procedurave Administrative,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 2 të dispozitivit të vendimit të KKRT-së nr.83, datë 25.2.2011, si vijon:
“Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative””.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Anëtar në mungesë: Zylyftar Bregu

Anëtar kundër (për arsye procedurale): Gent Ibrahim

KRYETARE
Endira Bushati

KËRKESË
Nr.297/13, datë 16.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i kopshtit dhe shkollës fillore, publike “Kaludh”, komuna Petran, Përmet, ku subjekti kërkues i këtij objekti është komuna Petran, Përmet.

Me anë të këtij publikimi në shtyp, kërkohmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm për procedurat e shpronësimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për pronarin sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, adresa: Rruga e Durrësit, nr.23, Tiranë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

LISTA E PRONARIT DO TË SHPRONËSOHET SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË KOPSHTIT DHE
SHKOLLËS FILLORE, PUBLIKE “KALUDH”, KOMUNA PETRAN, PËRMET

Pronari	Zona kadastrale	Nr.i pasurisë	Sip. truallit m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e tokës (lekë)	Vlera totale e shpronësimit (lekë)
Llukan Vangjel Theodhori	2057	589/3	300	999	299 700	299 700

Vlera totale e këtij shpronësimi është 299 700 (dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind) lekë.

KËRKESË
Nr.1312, datë 15.3.2011

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kuçovë-Belsh-Cërrik” (loti I-5 km).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarohmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet për pasurinë e llojit: tokë arë, objekt truall dhe kultura bujqësore. Kompensimi për efekt shpronësimi do të bëhet pas miratimit të kërkesës për

shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi pronarët e pasurive të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit për: tokë arë, truall, objekt, kultura bujqësore dhe dru frutorë është 5 258 997 (pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Oildashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“KUÇOVË-BELSH-CËRRIK”

						Lloji i pasurisë						Objekte		Totali	Shënime	
						Sip.shpronës.	Arë		Truall		K.Bujq. K.dru frutorë					
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr.Pas	m ²	Çmimi	Vlera (lekë)	Çmimi	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)	Lloji	Vlera (lekë)	Vlera (lekë)	Konf. ZVRPP
1.	Halit	Xhafer	Paja	2598	306/4	79	250	19750			799				20549	Konf. ZVRPP
2.	Belul	Riza	Tafani	2598	306/5	189	250	47250			1756				49006	Konf. ZVRPP
3.	Ismail	Hasan	Paja	2598	306/8/1	38	250	9500				11400			20900	Konf. ZVRPP
4.	Kristaq	Hasan	Paja	2598	306/10	3	250	750							750	Konf. ZVRPP
5.	Petrit	Hasan	Paja	2598	306/11	293	250	73250			5127.5				78377.5	Konf. ZVRPP
6.	Behar	Faik	Tafani	2598	306/12	635	250	158750			6840				165590	Konf. ZVRPP
7.	Rustem	Faik	Tafani	2598	306/13	878	250	219500			8462				227962	Konf. ZVRPP
8.	Misir	Xhafer	Paja	2598	324/6	528	250	132000			9970				141970	Konf. ZVRPP
9.	Xhafer	Halit	Paja	2598	324/2	200	250	50000			3040				53040	Konf. ZVRPP
10.	Rushan	Haxhi	Kuqja	2598	383/13	667	250	166750			10800				177550	Konf. ZVRPP
11.	Ruzhdi	Pasho	Kuqja	2598	377/21	145	250	36250			2349				38599	Konf. ZVRPP
12.	Ruzhdi	Pasho	Kuqja	2598	377/20	268			600	160800					160800	Konf. ZVRPP
13.	Ruzhdi	Pasho	Kuqja	2598		50 m ² objekt							Karburant	2534817	2534817	Leje ndërtimi
14.	Fatmir	Shyqeri	Kuqja	2598	377/6	73	250	18250			1183				19433	Konf. ZVRPP
15.	Fatmir	Shyqeri	Kuqja	2598	377/8	129	250	32250			4473				36723	Konf. ZVRPP
16.	Azbije	Shaqir	Kuqja	2598	377/9	129	250	32250			26052				58302	Konf. ZVRPP
17.	Shefqet	Mehmet	Kuqja	2598	377/10	170	250	42500			2730				45230	Konf. ZVRPP
18.	Bukuri	Murat	Kuqja	2598	377/11	159	250	39750			2596				42346	Konf. ZVRPP
19.	Niko	Kadri	Kuqja	2598	377/12	106	250	26500			1717				28217	Konf. ZVRPP
20.	Faik	Kadri	Kuqja	2598	377/13	327	250	81750			5314				87064	Konf. ZVRPP
21.	Besim	Mehmet	Kuqja	2598	377/15	877	250	219250			13904				233154	Konf. ZVRPP
22.	Hajdar	Pasho	Kuqja	2598	372/1	695	250	173750				82398			256148	Konf. ZVRPP
23.	Ruzhdi	Pasho	Kuqja	2598	372/2	589	250	147250			9538				156788	Konf. ZVRPP
24.	Pasho	Mehmet	Kuqja	2598	372/3	78	250	19500			797				20297	Konf. ZVRPP
25.	Nazmi	Pasho	Kuqja	2598	372/4	94	250	23500			1788				25288	Konf. ZVRPP
26.	Agim	Pasho	Kuqja	2598	372/5	85	250	21250			873				22123	Konf. ZVRPP
27.	Fatmir	Shyqeri	Kuqja	2598	372/8	252	250	63000			4473				67473	Konf. ZVRPP
28.	Azbije	Shaqir	Kuqja	2598	372/9	1390	250	347500				143000			490500	Konf. ZVRPP
			Shuma			9076		2202000	600	160800	124582	236798		2534817	5258997	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.4.2011
Doli nga shtypi më 5.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 42 lekë